

## **Deklaratë për media e Qëndrim Gashit, anëtar themelues i FER-it**

Prishtinë, më 28 mars 2011

Në tetor të vitit të kaluar u bëra anëtar themelues i partisë më të re në Kosovë, Fryma e Re - FER, i bindur se përfshirja dhe kontributi i të rinjve dhe i kuadrit të diasporës në politikë është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm politik në Kosovë dhe për një të ardhme më të mirë për popullin e Kosovës.

Aktiviteti im politik gjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore, por të turbullt, e ka farkëtuar edhe më tej besimin tim të thellë se politika kosovare ka nevojë të madhe për njerëz, ide, dhe frymë të re.

Me këtë deklaratë dëshiroj të ju njoftoj juve, afër 8 mijë votuesit e mi zemërgjerë, vullnetarët dinjitozë, zgjedhësit besimplotë dhe përkrahësit e palodhur të FER-it, se nga sot heq dorë nga aktiviteti i mëtejshëm në Partinë FER, pikërisht për ta riafirmuar përkushtimin tim për përfshirje dhe kontribut të efektshëm në politikë.

Arsyet për këtë vendim të gjatëmenduar dhe jo të lehtë janë pasivizmi e mungesa e vullnetit serioz në Partinë FER, për t'u marrur me sfidat aktuale me të cilat ballafaqohet Kosova dhe vet FER-i, si dhe me sfidat e së ardhmes.

Për mendimin tim, partia duhet të ushtrojë plotësisht funksionet e saja dhe duhet që të jetë aktive në përpjekjet për të realizuar qëllimet edhe kur nuk është në pushtet. Mendoj se ka hapësirë të gjerë veprimi edhe duke ngelur në opozitë dhe pikërisht në këtë fazë do të duhej të kishte nisur një dinamikë tjetër e punës në FER për tu bërë gati për sfidat e së ardhmes.

Unë do t'i analizoj rrethanat e veprimit politik të ardhshëm dhe do ta bëj atë të njohur me kohë. Më lejoni ta potencoj, sa për të mos u keqinterpretuar, se unë do të vazhdoj të qëndroj në Kosovë dhe të merrem më politikë, dhe se arsyeja pse unë po heq dorë nga aktiviteti i mëtejshëm në FER nuk ka të bëjë në asnjë mënyrë me ndonjë ofertë apo kalim në ndonjë parti tjetër.

Në ndërkohë, obligimi e përkushtimi im për ta vazhduar përfaqësimin e parimeve dhe ideve të proklamuar më herët të integritetit, kompetencës dhe vizionit, do të më ndihmojnë në vazhdimin e jetës sime politike, edhe pse jashtë kornizës politike të partisë aktuale.

Më lejoni me këtë rast që t'i dërgoj mesazh falenderimi të sinqertë dhe mirënjohje të thellë votuesëve të mi, si dhe kolegëve, vullnetarëve, dhe zgjedhësve dhe përkrahësve të FER-it.